



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 8, datë 27.02.2015

**Për
“MIRATIMIN E PËRFUNDIMIT TË PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË
BANESAVE, TË CILAT KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË ZYRËN E
REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PËR LIDHJEN
E KONTRATAVE PARA NOTERIT”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 32, shkronja “e” dhe nenit 33, pika 4 të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, (i ndryshuar); nenit 39/1, pika 1 e ligjit nr.9232, datë 13.05.2004 për “Programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, (i ndryshuar); pikës 1 dhe 14 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.97, datë 03.02.2008 për “Procedurat e privatizimit të banesave shtetërore”; dhe vendimit të Këshillit Bashkiak nr.29, datë 29.09.2008 për “Përcaktimin e njësisë përgjegjëse për ndjekjen e procedurave të privatizimit të banesave, objekt i ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 për “Privatizimin e banesave shtetërore” dhe të ligjit nr.9321, datë 25.11.2004 për “Privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyer në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të përfundohen procedurat e privatizimit të banesave, përkatësisht lidhja e kontratave të shitblerjes para noterit, banesat e të cilëve kanë mbetur pa u regjistruar pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për:

Nr	EMRI MBIEMRI	ADRESA
1	Agim Alikaj	Rruga “Qamil Guranjaku”, pall. 14/1, shk.7, ap.10
2	Xhevahir Allgjata	Rruga “Todi Shkurti”, pall. 5/1, shk.2, ap. 1/1
3	Arjan Gjenerali	Rruga “Riza Cuka”, pall.4, shk.5, ap.55
4	Bekim Kasemi	Rruga “Gjin Bue Shpata”, pall.5, shk.1, ap.1/1
5	Shpresa Lleshi	Blv. “Bajram Curri”, pall. Agimi, shk.15, ap.275
6	Arben Tahiri	Rruga “Irfan Tomini”, pall.7, shk.1, ap.5
7	Myrfet Totolaku	Rruga “Njazi Meka”, pall.11, shk.1, ap.14
8	Margarita Kona	Rruga “Myslym Shyri”, pall. 46, shk. 1, ap.3
9	Fejzie Sina	Rruga “Qemal Stafa”, pall.11, shk.2, ap.11
10	Lulzime Meta	Rruga “Gjergj Legisi”, pal.2, shk.1, ap. 3/1
11	Flutura Koçi	Rruga “Hamdi Pepa”, banesa nr.27/2
12	Qamil Topi	Rruga “Ferit Xhajko”, pall. 63/6, shk.1, ap. 1/1

13	Shefqet Tashi	Rruga “Muhamet Gjollesha”, pall.8, shk.1, ap.6
14	Bujar Gega	Rruga “Bajram Curri”, pall.490/5, shk.1, ap.2
15	Zija Dedej	Rruga “Shinasi Dishnica”, pall.96/1, shk.1, ap.10
16	Bardh Markoçi	Rruga “Bajram Curri”, VKB nr.29, datë 20.07.2005
17	Leke Leskaj	Rruga “Shinasi Dishnica”, pall.96/1, shk.1, ap.8
18	Agim Hyska	Rruga “Aleksandër Moisiu”, pall.66, shk.11, ap.3
19	Hito Hitaj	Blv. “Shqipëria e Re”, pall. “1 Maj”, shk.16, ap.31
20	Hasan Doka	Rruga “Marsel Kashen”, pall.6, shk.2, ap.16
21	Elmaz Çekrezi	Rruga “Hamdi Pepa”, pall.35, shk.3, ap.4

2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Tiranës ose personi i autorizuar prej tij për lidhjen e kontratës së privatizimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

ALDRIN DALIPI